



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:048431
Datë: 27.06.2024
Numri i dokumentit: 05870789

CAP.nr.757/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren individuale Nora Bllaca-Dula, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KRU “P.....” sh.a me seli në P....., kundër debitorit H.Th, me adresë në P....., rruga "....." C-....., hyrja, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.N, avokat në Prizren, për shkak të borxhit lidhur me shërbimet e ujësjellësit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.328/2021, i datës 29.01.2024, me datë 27.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditores KRU “P.....” sh.a me seli në P....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.328/2021, i datës 29.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.328/2021, i datës 29.01.2024, ka vendosur si në vijim: “ *APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit H.Th i datës 08.02.2021, ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri Përmbarimor i Përmbaruesit Privat A.B në P....., P.nr.54/2021 i datës 22.01.2021, dhe ANULOHEN të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbarimore.*”

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e

Kosovës këtë ankesë ta aprovojë si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ose ta ndryshoj aktvendimin e atakuar duke e refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja KRU "P....." sh.a në P....., ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstrakti (kartela financiare e debitorit) Nr.6812, në shumën e detyrimit në lartësi prej 1.497,34€.

Përmbartuesi privat, e ka lejuar përmbartimin me urdhrin përmbartimor P.nr.54/2021, të datës 22.01.2021.

Kundër urdhrin për përmbartim, debitori H.Th përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar prapësimin, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbartim. Në prapësim debitori ka theksuar lejimi i përmbartimit është në kundërshtim me nenin 360 paragrafi 1 nën-paragrafi 1 të LMD-së, pasi që sipas tij kanë kaluar afatet kohore për kërkimin e borxhit. Kjo për shkak se propozimi për përmbartim është ushtruar me datë 22.01.2021, ndërkaq pagesa e fundit është bërë me datë 21.01.2020 nga e cila datë edhe ka rrjedhur parashkrimi. Ndaj edhe i ka propozuar gjykatës që ta detyroj kreditorin ta shlyej borxhin e parashkruar nga regjistri i konsumatorëve.

Kreditori ka parashtruar përgjigje ndaj prapësimin të debitorit, përmes së cilës e ka kundërshtuar prapësimin si të pabazuar, meqenëse i njëjti nuk bazohet në asnjë provë dhe si i tillë është edhe i paargumentuar. Në përgjigje kreditori ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit për parashkrimin e borxhit, pasi që janë në kundërshtim me nenin 368 të LMD-së. Duke i pasur parasysh të thënat si më lartë Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa debitori të detyrohet të përmbush detyrimin e tij.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.328/2021, të datës 29.01.2024, me të cilin ka vendosur që ta aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar, ndërsa urdhrin përmbartimor, P.nr.54/2021, të datës 22.01.2021, e ka anuluar, më decidivisht sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se pas shiqimit dhe analizimit të shkresave të lëndës propozimi me Urdhër për Përmbartim është lëshuar në bazë të faturës me shifër 6812, derisa propozimit i është bashkangjitur vetëm Kartela Financiare e Konsumatorit, për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë, për borxhin në shumë prej 1,497.34 €. Tutje, derisa në propozim nuk është specifikuar periudha kohore për të cilën kërkohet

përbarimi i borxhit, gjykata gjen se Kartela Financiare e Konsumatorit është lëshuar për periudhën prej 01.01.2013 – 19.01.2021, mirëpo në të njëjtën të dhënat në baza mujore janë paraqitur vetëm nga data 31.12.2013 e deri me datë 31.01.2021. Tutje, në Kartelën Financiare të Konsumatorit në rubrikën e faturës së datës 31.12.2013 është evidentuar saldo në shumë prej 1,032.00 € e për të cilën nuk ka të dhëna se cilës periudhë kohore i përket. Tutje nga përlllogaritja e borxhit, gjithmonë sipas dokumentit përbarimor, gjykata ka konstatuar se borxhi i përgjithshëm për një vit kalendarik nuk e ka arritur asnjëherë shumën e saldos fillestare. Nga rrjedh se saldoja fillestare prej 1,032.00 € nuk i përgjigjet borxhit për një vit ashtu siç e ka paraqitur kreditori. Në rastin konkret, gjykata gjen se përbaruesi privat me Urdhrin P.nr.54/2021 i datës 22.01.2021 ka lejuar përbarimin, ndonëse propozimi për përbarim është lejuar në bazë të faturës, ndërsa i është bashkangjitur Kartela Financiare të Konsumatorit. Pastaj, propozimi nuk përmban të dhëna se për cilën periudhë kohore është kërkuar përbarimi, e poashtu edhe dokumenti i bashkangjitur nuk është në përputhje me kriteret ligjore për t'u konsideruar si i përshtatshëm për përbarim ngase, përveç të metave të cekura më lartë, nuk ofron informata as mbi kohën e përmbushjes së detyrimit monetar. Gjykata, në një gjendje të konstatuar si më lartë, erdhi në përfundim se procedura përbarimore në këtë rast, është caktuar pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e Urdhrit Përbarimor ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore të cekura më sipër, për faktin se mungon periudha kohore për të cilën kërkohet përbarimi si dhe dokumenti mbi bazën e të cilit është caktuar përbarimi nuk i ka përmbushur kushtet ligjore për të qenë i përshtatshëm për përbarim, andaj gjykata duke u bazuar në këtë fakt ka aprovuar prapësimin e debitorit si të bazuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë në dispozitiv të vendimit duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar. Me dispozitën e nenit 29 par.3 të LPP-së përcaktohet *“dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa neni 38 par 1 i LPP –së, përcakton se: *“Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit”*, ashtu që pas analizimit të shkresave të lëndës, shihet se kreditori në propozimin për përbarim nuk ka specifikuar periudhën për të cilën kërkon borxhin, element ky i nevojshëm për zbatimin e përbarimit, prandaj, pasi që nuk dihet periudha për të cilën kërkon borxhin, nuk mund të pranohet as ekstrakti me saldo fillestare në lartësi prej 1.497,34 euro, për arsye se nuk dihet periudha e faturuar, andaj vlerësimin e gjykatës së shkallës

lidhur me aprovimin e prapësimit dhe shfuqizimin e Urdhrit Përmbarrimor, e sheh si të drejtë dhe në harmoni të plotë me dispozitat ligjore edhe kjo gjykatë.

Në këtë kontekst, edhe pretendimin ankimor të kreditores se gjykata e shkallës së parë ka llogaritur gabimisht këstet mujore dhe borxhin e krijuar, për arsye të lartcekura, kjo gjykatë nuk e pranoj si të bazuar, nga ku rezulton që propozimi për përmbarrim i kreditorit ka qenë i pa rregullt ku rrjedhimisht edhe Urdhri i lëshuar nga Përmbarruesi Privat është lejuar në harmoni me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, andaj kjo gjykatë refuzoj pretendimet ankimore të kreditores, ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetoj.

Në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit, Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme nga se nuk kanë bazë në prova konkrete

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
CAP.nr.757/2024, më datë 27.06.2024

Gjyqtarja,
Nora Billaca-Dula d.v